



Primitar / Prifera Primierno / Prifera Receiver / Delivery	10.01.2022	2	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jedinka Org / Unit	SRPMSTHCK	43/2022	1/3
Nr Prif Prif No.		Shtojca Prifog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1012/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari- anëtare, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1012/2021 të datës 07.12.2021 të parashtruar nga ankuesja

me

në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.61/2021 të datës 12.11.2021 të Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 10.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1012/2021 e datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.61/2021 i datës 12.11.2021 i Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

A r s y e t i m

Ankuesja 07.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5837/2021 të regjistruar me numër A.nr.1012/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Vendimi me Nr.61/2021 i datës 12.11.2021 për deklarimin e statusit të zyrtarit publikë është nxjerr në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarit Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa më datë 22.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5837/2021 të regjistruar me numër A.nr.1012/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 4742/2021 të datës 02.12.2021 lidhur me deklarin e statusit të nëpunësve civil në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sportit; Vendimin me numër te protokollit 4363/2021 të datës 12.11.2021 ; Akt Emërimit me numër të protokollit 160/2012 të datës 20.01.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6213/2021 të datës 17.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6287/2021 të datës 22.12.2021; Emalin e datës 09.06.2021; Listën për deklarin të statusit të zyrtareve publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.1012/2021 e datës 07.12.2021 është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në provat e lëndës, rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 20.01.2012 është i punësuar në pozitën e punës "Postiere" në Departamentin e Administratës Qendrore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Menaxheri i Personelit i Ministrisë së kulturës, Rinisë dhe Sportit më datë 12.11.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 61/2021 përmes të cilit ka bërë deklarin e statusit të zyrtarit publik për ankuesen duke e kategorizuar të njëjtën në kategorinë e Nëpunësve Administrativ dhe Mbështetës, sipas nenit 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi për deklarin të statusit të zyrtarit publikë është nxjerr në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.10/2020 për Deklarin e Statusit të Zyrtarit Publikë, sepse e njëjta pretendon se i është ndërruar statusi nga nëpunës civil me akt emërim, në nëpunës administrativ dhe mbështetës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se institucionit e administratës publike në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kanë qenë të obliguara që të bëjnë deklarin e statusit të zyrtarëve publikë, siç është përcaktuar me nenin 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht paragrafi 5 i këtij neni, ku përcaktohet se: *Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 6, ku përcaktohet se: *Nëpunës administrativo- teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike, dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi në kohen e deklarin të statusit ka qenë i emëruar në pozitën e*



punës "Postiere" vlerëson se organi i punësimit, me rastin e përcaktimit të statusit ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sepse i njëjti është kategorizuar si *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës* ashtu siç përcaktohet me nenin 2 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar si me lartë Kolegji konstaton se Vendimi me Nr.61/2021 i datës 12.11.2021 i Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për deklarimin e statusit të ankuesit dhe kategorizimi i tij si *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës* është në pajtim me nenin 2 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 83 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, andaj pretendimi ankimor i ankueses për shkelje të dispozitave ligjore me rastin e përcaktimit të statusit është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1012/2021

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MKRS; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

